



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1386 prot.

Elbasan, më 16.05.2024

VENDIM

Nr. 12, date 26.05.2024

**PËR MOS REGJISTRIMIN E KANDIDATURËS PËR POSTIN E AUTORITETIT
DREJTUES REKTOR I UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
TË PROF.DR. MAJLINDA SULEJMAN PERRIU**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024, si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr. 31, datë 17.05.2020 "Për zgjedhjen e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve", KIZ në mbledhjen e tij të datës 26.05.2024 pasi shqyrtoi aplikimin e Prof.dr. Majlinda Perriu për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", konstatoi se znj. Majlinda Sulejman Perriu aktualisht ushtron detyrën e Prefektit të Qarkut Elbasan, provuar kjo me dokumentin 'Vërtetim' me nr..592/1 prot. datë 20.05.2024.. Bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për prefektin e qarkut", neni 7, pika 2, në të cilin përcaktohet shprehimisht se; "*funksioni i prefektit të qarkut është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor e me çdo funksion tjetër publik, me përjashtim të mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe të veprimtarive shkencore*", KIZ në unanimitet,

V E N D O S I:

- 1- Të mos miratojë regjistrimin e kandidaturës për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Prof.dr. Majlinda Sulejman Perriu.
- 2- Ky vendim shpallet sot më datë 26.05.2024 dhe publikohet në ambientin dhe faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Florenc Piliçgriu

Anëtar: Armela Mazrreku

Anëtar: Mustafa Kadzadej

Anëtar: Julian Çota

Anëtar: Behije Gollobërda

Anëtar: Marsel Sulanjaku

Anëtar: Klodjana Maloku